

Vritet me armë zjarri një person në Prishtinë, dy të tjerë plagosen nga një mjet i mprehtë

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

18/03/2023 14:48

f

🐦

🔗

Një person është vrarë nga arma e zjarrit në Prishtinë.

Siç ka konfirmuar Policia e Kosovës, rasti ka ndodhur në lagjen “Dragodan” të kryeqytetit, shkruan lajmi.net.

Nga Policia e Kosovës kanë bërë me dije gjithashtu se rasti ka ndodhur në një hotel dhe se edhe dy persona kanë përfunduar të plagosur nga një mjet i mprehtë.

“Sot rreth orës 13:20 policia ka marrë informatën për të shtëna me armë zjarri, në lagjen Arbëria të Prishtinës, saktësisht në një hotel. Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet e nevojshme policore dhe ekipi mjekësor. Bazuar në të dhënat fillestare nga arma e zjarrit lëndime ka pësuar një person, i cili në vendngjarje ka ndërruar jetë, vdekjen e tij e ka konstatuar ekipi mjekësor. Ndërsa dy persona të tjerë të lënduar(dyshohet me mjet të mprehtë) janë dërguar për tretman mjekësor. Aktualisht hetuesit policor, në koordinim me prokurorin e shtetit janë duke punuar për të ndriçuar dhe sqaruar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me këtë ngjarje”, kanë thënë nga Policia për lajmi.net.

Artikuj të ngjashëm



March 18, 2023

Escobar: Jemi të fokusuar te finalizimi i marrëveshjes, jo te nënshkrimi



March 18, 2023

Zëvendës-kryeministria Rexhepi e bën të rëndësishëm kabinetin qeveritar, thotë se ky...



March 18, 2023

“Amerikanët e kanë mbyllur derën me çelës, nuk do t'i lënë...



March 18, 2023

Kongresmenët amerikanë letër Blinkenit: Të drejta të barabarta për shqiptarët në...



March 18, 2023

“Kokë më kokë” më shumë se zakonisht, tri orë nga fillimi...



March 18, 2023

Sheholli flet me burime: Ka ngërç në takimin Kurti – Vuçiq,...